



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË



Lënda: GJEOGRAFIA E SHQIPËRISË (Pjesa II-të)

<i>Pedagogu:</i>	Prof. dr. Dhimitër Doka
<i>Ngarkesa:</i>	6 ETCS (2 leksione dhe 1 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	e detyrueshme
<i>Programi i studimit:</i>	Bachelor, gjeografi
<i>Viti/semestri:</i>	III/I

Përshkrimi: Gjeografia e Shqipërisë, Pjesa e II-të, zhvillohet në kursin e tretë të degës gjeografi, semestri parë. Ajo ka për qëllim plotësimin e mëtejshëm të njohurive të studentëve në kuadër të lëndës Gjeografia e Shqipërisë. Objekt i lëndës është analiza e dukurive dhe fenomeneve që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë dhe ekonomisë në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe aspekteve më të rëndësishme humane që lidhen me to. Trajtimi i problematikës realizohet si në këndvështrimin historik, ashtu edhe aktual. Rëndësi e veçantë i kushtohet problematikave të transformimit demografik dhe ekonomik të vendit pas vitit 1990. I gjithë ky i ndihmon studentët për të analizuar perspektivat dhe strategjitë e zhvillimit të ardhshëm human të vendit.

Temat e leksioneve:

- 1. Hyrje.Njohje me lëndën dhe objektin e saj të studimit.** Vendi i Gjeografisë Humane të Shqipërisë në kuadër të Gjeografisë Humane në përgjithësi. Përmbajtja dhe rëndësia e studimit. Metodatat e përdorura dhe mënyrat e realizimit.
- 2. Pozita gjeopolitike e Republikës së Shqipërisë dhe roli i saj në zhvillimin social-ekonomik të vendit.** Ndryshimet në hartën politike të Shqipërisë. Organizimi administrativ dhe territorial i Shqipërisë në periudha të ndryshme.
- 3. Popullsia dhe vendbanimet në Shqipëri.** Historia e popullimit të trevave shqiptare dhe vazhdimësia iliro-shqiptare. Ndryshimi i numrit të përgjithshëm të popullsisë së Shqipërisë.
- 4. Tipare të shpërndarjes gjeografike të popullsisë në Shqipëri.** Faktorët që kanë ndikuar në shpërndarjen gjeografike të popullsisë në Shqipëri. Dendësia e popullimit dhe ecuria e saj.
- 5. Ndryshime strukturore të popullsisë së Shqipërisë.** Shtesa natyrore e popullsisë, treguesit e saj dhe ndryshimet që ka pësuar në kohë dhe hapësirë. Struktura moshore, gjinore dhe sociale e popullsisë.
- 6. Migrimi i popullsisë – promotor i gjithë ndryshimeve demografike në Shqipëri,** veçanërisht pas vitit 1990.
- 7. Emigracioni i jashtëm – dukuri e herëshme, por edhe aktuale e shqiptarëve.** Migrimi i brendshëm i popullsisë në Shqipëri. Format dhe drejtimet e tij.
- 8. Struktura e vendbanimeve në Shqipëri.** Evoluimi i strukturës së popullsisë sipas vendbanimeve. Vendbanimet rurale dhe urbane. Proceset e urbanizimit në Shqipëri.
- 9. Gjeografia e Ekonomisë së Shqipërisë.** Vlerësim ekonomik i mjedisit gjeografik natyror të Shqipërisë. Karakteristika të përgjithëshme të zhvillimit dhe shpërndarjes gjeografike të ekonomisë së Shqipërisë në periudha të ndryshme.
- 10. Veçori të transformimit ekonomik të Shqipërisë pas vitit 1990.** Kushtet e reja politiko-shoqërore në Shqipëri dhe ndikimi i tyre në zhvillimin dhe shpërndarjen e ekonomisë.

11. Ekonomia bujqësore në Shqipëri. Potencialet natyrore dhe humane për zhvillimin e ekonomisë bujqësore. Reformat në bujqësi dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e vendit.

12. Bujqësia shqiptare në transformim. Privatizimi në bujqësi dhe problematikat që e shoqërojnë atë. Braktisja e fshatit dhe efektet e saj në zhvillimin bujqësor. Rajonet e sotme bujqësore dhe specifikat e zhvillimit të tyre.

13. Industria në Shqipëri. Kushtet natyrore, shoqërore dhe teknike për zhvillimin e industrisë. Politika industriale e ndjekur në Shqipëri dhe efektet hapësinore të saj.

14. Struktura e degëve të industrisë dhe përhapja gjeografike e tyre. Rajonet industriale dhe problemet e riaktivizimit të tyre. Perspektiva dhe strategji të zhvillimit industrial të vendit.

15. Sektori terciar i ekonomisë në Shqipëri. Rëndësia e degëve të sektorit terciar të ekonomisë, vecanërisht pas vitit 1990. Transporti, tregtia, shërbimet, turizmi. Tipare gjeografike të zhvillimit të tyre.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve

- Angazhimi në seminare:

10% e notës

- Testi I: në javën e 6-të

10% e notës

- Testi II: në javën e 10-të

10% e notës

- Detyra e kursitose ese: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):

20% e notës

- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim

50% e notës

- Gjithsej:

100%

Literatura e detyrueshme për studentin:

1. Doka, Dh. (2015): Gjeografia e Shqipërisë (Popullsia dhe Ekonomia). Tekst Universitar

2. Doka, Dh. (2005): Tipare gjeografike të zhvillimit socio-ekonomik dhe rajonal të

Shqipërisë pas vitit 1990. Potsdam – Gjermani.

Literatura plotësuese:

1. Doka, Dh. (1997): Migrimi dhe proceset social-ekonomike të Shqipërisë në periudhën e tranzicionit. Në: “Studime Gjeografike”. Nr. 10. Tiranë.

2. Doka, Dh. (1997): Industria – objekt i studimit gjeografik. Në: “Ekonomia dhe Biznesi”. Nr. 3. Tiranë.

3. Mara, H., Gedeshi, I. (2000): Transicioni ekonomik në Shqipëri dhe integrimi i saj rajonal dhe global.

Në: “Zhvillimi ekonomik-shoqëror i trojeve shqiptare dhe integrimi i tyre rajonal dhe botëror”. Faqe 29-54. Tiranë, Prishtinë, Shkup.